



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 100/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Rafet Haxhaj dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulomtuese (BIRN), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të vendosjes së posterave me përmbajtje të fushatës parazgjedhore afër Qendrës së Votimit (QV) 1103x gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 26.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulomtuese (BIRN).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë me datë 24.01.2011, nga organizata BIRN, me te cilën pretendohet se në QV 1103x shkolla fillore “Shaban Idrizi” në fshatin Zhabar komuna e Mitrovicës, afër kësaj qendre ka pasur të vendosur postera të subjektit politik PDK të cilit ishin me përmbajtje të fushatës parazgjedhore. Sipas parashtruesit të ankesës këta postera kanë qenë të vendosur në objekt privat mirëpo nuk kanë qenë më larg se 50 metra nga QV-ja. Më këtë parashtruesi i ankesës konsideron se është bërë shkelje e nenit 36.1 të LZP-së.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se ka ndodhur shkelja e theksuar në ankesë janë të pabazuara për shkakun se dëshmitë e ofruara nuk ofrojnë mundësi për të vertetuar faktin e pretenduar. Nga fotot e paraqitura prej BIRN, është e paqarte vendodhja e QV-se perkatese si dhe vertetimi i largesise se posterit të subjektit politik nga QV-ja. Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 100/2011 më datën 26.01.2011

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

